




01-1915



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-191910/20 dt. 20.10.2020, të pronarëve Xhavit Mermullakaj, Smajl Sekiraqa, Fahri Berisha dhe Baki Berisha, dhe bashkëinvestitorëve ”Protech” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Kujtim Gashi, ”Uniproject” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Afrim Raifi, dhe ”Arking” sh.p.k., me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Albert Domi, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “A22”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Përllëshi” dhe “Ibe Palikuqi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 18.04.2021, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Xhavit Mermullakaj, Smajl Sekiraqa, Fahri Berisha dhe Baki Berisha nga Prishtina, dhe bashkëinvestitorëve ”Protech” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Kujtim Gashi, ”Uniproject” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Afrim Raifi, dhe ”Arking” sh.p.k., me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Albert Domi, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-191910/20 dt. 20.10.2020, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm me etazhitet 2B+P+11 e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-120357 dt. 14.11.2016, në parcelën kadastrale nr. 1577-0, (produkt i bashkimit të parcelave kadastrale me nr. 43-3, 42-6, 42-7 dhe 39-2) e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01577-0, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urbanistik “A22”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugët “Ndue Përllëshi” dhe “Ibe Palikuqi”, ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 3, 5, 42, 44, 46, 48, 50, 52 në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarëve Xhavit Mermullakaj, Smajl Sekiraqa, Fahri Berisha dhe Baki Berisha nga Prishtina, me investitor ”Protech” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Kujtim Gashi nga Prishtina, ”Uniproject” sh.p.k., me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Afrim Raifi, dhe ”Arking” sh.p.k., me seli në Gjakovë, përfaqësuar nga Albert Domi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-191910/20 dt. 20.10.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet 2B+P+9, të ndërtuara në kuadër të bllokut urbanistik “A22”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale në parcelën kadastrale nr.1577-0 (produkt i

Faqe 1 prej 3



bashkimit të parces kadastrale me nr. 6460, parces kadastrale me nr. 6461), parces kadastrale me nr. 6462), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-01577-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-173050 dt. 28.10.2013, dhe Konkluzionit 05 Nr. 351-173050 dt. 13.11.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-112065/20 dt. 18.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Merita Domi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Shpend Rada; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetillësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Kujtim Gashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Teuta Berisha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Vedat Sjeniçaku; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhelal Osmani me nr. të licensës 31;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetillësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.



Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuetit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-191910/20 DT. 18.04.2021**

Zyrtarja,
Bahtije Villasaliu

B. Villasaliu

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi

M. Berisha Prestreshi



